



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 04 Mars 2022

Nr: 11

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 05, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN
03.03.2022**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.03.2022, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Bashkia Shkodër, përfaqësuar nga kryetarja zj. Voltana Ademi

PALË E INTERESUAR: Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, përfaqësuar në cilësinë e partisë udhëheqëse “Lëvizja Socialiste për Integrim” nga z. Altin Kaziaj

OBJEKT: Kërkesë për shpalljen e pavlefshme të vendimit nr. 116, datë 02.03.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124/1, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pika 8, e nenit 9, të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Rrethanat e çështjes:

1. Kryetarja e Bashkisë Shkodër, me shkresat nr. 2847 prot., datë 22.2.2022, nr. 3179 prot., datë 25.02.2022 dhe nr. 3288 prot., datë 28.02.2022 ka paraqitur kërkesë pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për dhënien e autorizimit nga ana e KQZ-së për ndryshimin e 12 (dymbëdhjetë) qendrave të votimit të njësive administrative Shalë, Shosh dhe Pult, me arsyetimin se, për shkak të kushteve atmosferike të momentit dhe të parashikimit sinoptik për ditën e zgjedhjeve, vështirësohet ose bëhet i pamundur votimi i shumicës së zgjedhësve të këtyre qendrave të votimit.
2. Shumica e zgjedhësve të këtyre qendrave të votimit, sipas kërkueses, “dimërojnë” çdo vit brenda ose në rrethinat e qytetit të Shkodrës, për shkak se zona e tyre e vendbanimit bllokohet gjatë gjithë dimrit nga dëbora dhe aksesit në këto zona bëhet i pamundur. Për këtë arsye, votimi i tyre në qendrat periferike të qytetit “do t’u garantonte atyre të drejtën e votimit”, të cilën ata nuk mund t’a ushtrojnë dot, në rast se qendrat e tyre të votimit nuk zhvendosen rreth 60 km nga zona ku kanë vendbanimin e regjistruar në gjendjen civile.
3. Gjithashtu, kërkuësja ka konsideruar se, për shkak të dimrit dhe bllokimit nga dëbora, vetë mjediset e QV-ve janë të papërshtatshme për zhvillimin e procesit të votimit për shkak të lagështirës, amortizimit të lartë, mungesës së energjisë elektrike, ujit, internetit etj.
4. Rrethanat e parashtruara nga kërkuësja, vlerësohen prej saj si rrethana që përbëjnë forcë madhore, në kuptimin e fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 62 të Kodit Zgjedhor, për pasojë, formojnë shkak të ligjshëm për të kërkuar autorizimin për ndryshimin e vendndodhjes së këtyre QV-ve.
5. Me vendimin e tij nr. 116, datë 02.03.2022, Komisioneri ka refuzuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit nr. 0115, 0116, 0117, 0118, 0119, 0119/1, 0132, 0133, 0091, 0092, 0093 dhe 0094, kërkuar nga Bashkia Shkodër, si dhe ka vendosur t’i kërkojë Autoritetit Rrugor Shtetëror dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, marrjen e masave për sigurimin e aksesit të rrugëve dhe energjisë elektrike në zonat e qendrave të votimit në njësitet administrative Shosh, Pult dhe Shalë.
6. Kërkuësja ka bërë ankim brenda afatit ligjor kundër këtij vendimi, duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe autorizimin nga KAS-i për ndryshimin e vendndodhjes së QV-ve, sipas kërkesës së parashtruar.



7. KAS-i caktoi me short relatorin z. Elvin Lako dhe në mbledhjen e datës 04.03.2022 pranoi për shqyrtim dhe shqyrtoi në themel ankimin, me praninë e ankueses zj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër dhe të administratës së KQZ-së, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj. Në seancë u kërkua nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor “Shtëpia e Lirisë”, z. Altin Kaziaj përfshirja me cilësinë e palës së interesuar. KAS-i pranoi kërkesën dhe lejoi subjektin zgjedhor të marrë pjesë me cilësinë e palës së interesuar.

8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- kërkesën ankimore nr. 04, datë 03.03.2022 të Kryetares së Bashkisë Shkodër;
- shkresat e Kryetares së Bashkisë Shkodër drejtuar KQZ-së me nr. 2847 prot., datë 22.2.2022, nr. 3179 prot., datë 25.02.2022 dhe nr. 3288 prot., datë 28.02.2022;
- shkresën e Kryetares së Bashkisë Shkodër drejtuar KQZ-së me nr.1165/1 prot., datë 28.01.2022;
- vendimin e Komisionerit nr.116, datë 02.03.2022.

Në përfundim të seancës së pyetjeve dhe pasi dëgjoi pretendimet e palëve,

KAS-i konstatoi:

Kërkuesja ka vënë në lëvizje Komisionerin me një kërkesë, e cila paraqet këto probleme ligjore:

1. Kompetenca për caktimin e QV-ve është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë, të cilën ai e ushtron në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 62 dhe 93 të Kodit Zgjedhor. Kryetarja e Bashkisë Shkodër e ka ushtruar këtë kompetencë, duke caktuar QV-të nr. 0115, 0116, 0117, 0118, 0119, 0119/1, 0132, 0133, 0091, 0092, 0093 dhe 0094 në territorin e njësive administrative Shosh, Pult dhe Shalë, sikurse konfirmohet nga shkresa e Kryetares së Bashkisë Shkodër drejtuar KQZ-së me nr.1165/1 prot., datë 28.01.2022. Në caktimin e vendndodhjes së këtyre QV-ve, Kryetarja e Bashkisë Shkodër ka respektuar kërkesat e Kodit për kushtet dhe kriteret, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, përfshirë sidomos kushtet për aksesin dhe komoditetin e nevojshëm për votim në mjediset e QV-së.
2. Në momentin e caktimit të QV-ve kanë qenë të njohura për Kryetaren e Bashkisë Shkodër si stina, kushtet gjeo-atmosferike, mundësitë e komunikacionit rrugor, ashtu dhe sjellja tipike e banorëve të zonës në këtë periudhë, sa i takon vendqendrimin të tyre të preferuar për “dimërim”.



Kryetarja e Bashkisë deklaroi në mënyrë të besueshme se ishte në dijeni se sa banorë gjendeshin në këtë periudhë në vendbanimin e tyre dhe se sa gjendeshin në qytetin e Shkodrës. Asnjë rrethanë nuk ka ndryshuar nga momenti i caktimit të QV-ve, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për ndryshimin e vendndodhjes së tyre, në mënyrë të veçantë asnjë rrethanë që mund të ketë lidhje me ngjarje të forcës madhore të ndodhura në këtë ndërkohë. Ka ndryshuar vetëm vlerësimi i Kryetares së Bashkisë Shkodër për këto rrethana.

3. Fjalja e dytë e pikës 4 të nenit 62 të Kodit Zgjedhor, sipas së cilës *“vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja”* kërkon që *“forca madhore”* të ketë lindur në intervalin 40 ditë para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, përndryshe ajo nuk mund të formojë shkak ligjor për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së. Zona e QV-së, sikurse vendndodhja e QV-së si rregull nuk ndryshojnë. *“Kufijtë ekzistues të zonës së qendrës së votimit nuk ndryshojnë...”* (fjalja e parë e pikës 3, të nenit 62 të Kodit Zgjedhor). *“Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur”* (fjalja e parë e pikës 4, të nenit 62 të Kodit Zgjedhor).
4. Ngurtësia e posaçme e Kodit në raport me kufijtë e zonës së QV-së dhe me vendndodhjen e QV-së, ka lidhje me respektimin e nevojës së zgjedhësve për të pasur qendrueshmëri dhe vazhdimësi në traditën e tyre të votimit. Vetëm rrethana objektive ose dalja/largimi nga kriteri i numrit minimal/maksimal të zgjedhësve në listë mund të formojnë shkak të ligjshëm për të cënuar këtë ngurtësi. Prishja apo rrënimi i godinës ku ka vendndodhjen QV-ja formon p.sh. shkak objektiv për zhvendosjen e saj, sikurse rënia e listës nën numrin minimal të zgjedhësve formon shkak ligjor për shkrirjen e zonës së QV-së dhe kalimin e saj në një zonë tjetër ngjitur me të.
5. Sa kohë që zona dhe vendndodhja e QV-së janë të lidhura ngushtësisht me numrin minimal/maksimal të zgjedhësve në listë, modifikimin e tyre sipas procedurës së zakonshme ligjore, Kodi Zgjedhor e ka lidhur pazgjidhshmërisht me procesin e hartimit të listave të zgjedhësve. Këtu e ka origjinën afati 40 ditor i parashikuar nga fjalja e dytë e pikës 4, të nenit 62, të Kodit Zgjedhor. Ai është identik me afatin 40 ditor të parashikuar nga fjalja e parë e pikës 1, të nenit 56, të Kodit Zgjedhor (*“Zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve...”*). Pas kalimit të këtij afati ndryshimi mund të bëhet vetëm për forcë madhore.

6. Fjalja e dytë e pikës 4, të nenit 62, të Kodit Zgjedhor kërkon gjithashtu që, “*forca madhore*” të ketë lidhje me mjedisin ku është vendosur QV-ja dhe me aksesin brenda territorit të zonës së QV-së, por jo me mundësitë e mira apo të këqija të komunikacionin me njësinë administrative, bashkinë apo më gjerë. Forca madhore në rastin e kësaj dispozite është e tillë që shmanget duke zhvendosur vendndodhjen e QV-së, brenda të njejtës zonë të QV-së ose në pamundësi në zonën ngjitur me të (kriteri ligjor i nenit 93). Rast tipik ilustrues është p.sh. kur godina ku është vendosur QV-ja rrënohet apo bëhet e papërdorshme në prag të zgjedhjeve. Rast tipik ilustrues është po ashtu kur për shkak të përmbytjeve, zjarreve apo orteqeve që ndodhin në prag të zgjedhjeve bëhet e pamundur për zgjedhësit e zonës së QV-së që të shkojnë në qendrën e tyre të votimit dhe kjo gjë mund të shmanget, duke zhvendosur vendndodhjen e QV-së diku tjetër brenda zonës së QV-së ose, në pamundësi, në zonën ngjitur. Kriteri ligjor i nenit 93 nuk mund të preket, sepse ai bazohet në marrëdhënien e pacënueshme “vendbanim - listë zgjedhësish - qendër votimi”, të cilën Kodi nuk lejon që të priset në asnjë rrethanë.
7. Kërkuesja ka kërkuar zhvendosjen e vendndodhjes së QV-ve në distancë 60 km nga vendndodhja e tyre e zakonshme, pavarësisht se, sikurse konfirmon KQZ-ja nuk ka asnjë pengesë për ngritjen dhe funksionimin në ditën e zgjedhjeve të QV-ve të specifikuar në kërkesë. Një zhvendosje e tillë mund të bëhet ligjërisht vetëm në rrugën e ndryshimit të vendbanimit, i cili passjell kalimin e zgjedhësit nga një listë zgjedhësish në një tjetër, nga një QV në një tjetër, sikurse mund të bëhet vetëm sipas procedurave dhe afateve që Kodi ka parashikuar për modifikimin e listës së zgjedhësve. Kompetencën për hartimin dhe përditësimin e listës së zgjedhësve e ka kryetari i bashkisë. Situata e “dimërimit” të zgjedhësve të Shalës, Shoshit dhe Pultit në qytetin e Shkodrës mund të zgjidhet ligjërisht, sipas përfytyrimit që ka kërkuesja për zgjidhjen, vetëm me mekanizimin ligjor të modifikimit të listës së zgjedhësve. Për zbatimin e këtij mekanizimi si Komisionerit, ashtu dhe KAS-it i mungon kompetenca, kurse kërkuesja e ka. Duhet vetëm t’u kishte vëvë në veprim brenda afateve të parashikuara nga ligji.
8. Kodi Zgjedhor ngarkon KQZ-në, bashkitë dhe institucionet, agjensitë dhe entet publike, secili sipas kompetencës, që të marrin të gjitha masat dhe të krjojnë të gjitha kushtet për mbarëvajtjen e procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve. Detyrimi është institucional. Mosfunksionimi i institucioneve, mungesa e vullnetit, pamundësia apo paaftësia për të kryer detyrën nuk formojnë “forcë madhore”, në kuptimin e fjalisë së dytë të pikës 4 të nenit 62 të Kodit. Administrata e KQZ-së konfirmoi në seancë se, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kishte garantuar furnizimin me energji elektrike të të gjitha qendrave të votimit. KQZ-ja vetë garantoj shpërndarjen e materialit zgjedhor, prezencën e komisionerëve në qendrat e votimit dhe

funksionimin e tyre të rregullt në ditën e votimit. Kodi kërkon që rrugët drejt QV-së të jenë të kalueshme brenda zonës së QV-së, për t'i dhënë mundësinë zgjedhësve që të aksesojnë QV-në. Nëse rrugët nacionale apo rurale që të çojnë nga një bashki në tjetrën, apo nga një njësi administrative në tjetrën janë të kalueshme apo jo, ky nuk është një problem specifikisht zgjedhor. Ky është problem administrativ i natyrës së përgjithshme dhe ka lidhje vetëm me performancën rutinë të entit pronar të rrugës. Nëse kjo performancë cënon procesin zgjedhor dhe në çfarë shkalle mund t'a cënojë atë, kjo nuk është një çështje që hamendësohet, por është një çështje që çmohet, vërtetohet dhe gjykohet a posteriori.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 143, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në shkronjën "b" të pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 05, datë 03.03.2022, të paraqitur nga Bashkia Shkodër.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 116, datë 02.03.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

